

Kërkesë për Ofertë 23-01-S4J

Ndërtimi dhe zhvillimi i faqes së internetit (webapp) - “Arsimi dhe Formimi Profesional” Pyetjet dhe Përgjigjet

Pyetjet e mëposhtme janë marrë nga aplikantët e interesuar për tenderin Kërkesë për Ofertë 23-01-S4J: Ndërtimi dhe zhvillimi i faqes së internetit (webapp) - “Arsimi dhe Formimi Profesional”. Nëpërmjet këtij dokumenti, pyetjet dhe përgjigjet rreth kësaj thirrjeje u vihen në dispozicion të gjithë ofertuesve të interesuar.

Pyetja 1

Kemi paqartësi që kanë të bëjnë me lidhjet e kërkuara me platformat më poshtë:

1. Lidhja me akpa.gov.al
2. Lidhja me puna.gov.al
3. Lidhja me platformën MesoVET
4. Lidhja me e-albania.gov.al

Në dokument përmendet si kërkesë vetëm lidhja me këto platforma. Ne kemi nevojë të dimë nivelin e sinkronizimit me secilën prej tyre.

Idealisht do na vlenë një listim i funksionaliteteve për secilën, psh:

- Me puna.gov.al do kërkohen këto lidhje:

1. Marrja me filtra dhe listimi pozicioneve të punës
2. Marrja dhe shfaqja e detajeve të një pozicioni pune
3. ...

Në pamundësi të një sqarimi të tillë, do na vlenë edhe një përcaktim i thjeshtë numerik i funksioneve në këtë format:

- Me puna.gov.al kërkohen:

- 3 Funksionalitete GET
- 2 Funksionalitete POST
- ...

Përgjigja 1

Përsa i përket lidhjeve të kërkuara me platformat më poshtë:

1. Lidhja me akpa.gov.al
2. Lidhja me puna.gov.al
3. Lidhja me platformën MesoVET

4. Lidhja me e-albania.gov.al

lidhja e kërkuar është vetëm hyperlink me këto platforma dhe jo ndërveprime në databazë.

Ndërsa në lidhje me sinkronizimin me secilën prej tyre, sqarojmë që në këto platforma nuk ka API për komunikime GET, POST.

Data 23 Janar 2023